



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.1.	RREZIQET FIZIKE
Nën-tema 2.1.6.	RREZATIMI JONIZUES
Ligji /rregulloret përkatëse:	• Ligji Nr.04/L-161/2013 për sigurinë dhe shëndetin në punë; • Praktikat më të mira nga vendet e rajonit dhe më gjerë.
Shkurtesa:	• MPSM – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale • PMR – Praktikat e Mira Regjionale
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Kjo listë kontrolli është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushën e zbatimit të Ligjit Nr.04 / L-161 për "Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe arsyet mbi të cilat puna ose trajnimi kryhen në vendet e punës ku ekziston rrezik për shëndetin për shkak të rrezatimit jonizues.
Përdorimi i listës së kontrollit:	Nëse përgjigjeni "Po" në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni "Jo" bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika e kontrollit	Po	Jo	Vërejtje për zbatim
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			
	* Edhe pse Republika e Kosovës nuk disponon një akt normativ për mbrojtjen e të punësuarve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese, në këtë listë kontrolli do të përfshihen disa çështje më elementare të praktikuara nga vendet regjionale, e që kanë të bëjnë me të punësuarit që punojnë me pajisje në fushën e mjekësisë siç janë pajisjet mjekësore për diagnostikimin me rreze X (stomatologji, mamografi, tomografi, stenting kardiak). * Pajisjet mjekësore që përdoren për terapi radiofarmike, pajisjet mjekësore për terapinë me rrezatim me rreze X në radiologji. * Proceset e prodhimit me pajisje për testimin e cilësisë së produktit (prodhimi i cigareve), portale me detektorë metali (për personat që hyjnë në institucionet qeveritare, bankat, kazinotë, aeroportet, inspektimi i bagazheve etj.). * Mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së këtij legjislacioni nuk e ushtron			

	<i>Inspektorati i Punës, por Institucione profesionale të akredituara, varësisht nga shteti.</i>			
1.	A bëhet vlerësimi i nivelit të ekspozimit? PMR			
2.	A është punëdhënësi përgjegjës për: – mbrojtjen e të punësuarëve nga ekspozimet profesionale? – përmbushjen e çdo kërkesë të legjislacionit dhe standardeve të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese? PMR			
3.	A zbatohen kërkesat e standardeve të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese për çdo ekspozim profesional, nga çdo burim natyror ose artificial? PMR			
4.	A planifikohet dhe a realizohet vlerësimi i riskut dhe matja e burimeve të rrezatimit sipas legjislacionit në fuqi? PMR			
5.	A janë përcaktuar ekspozimet profesionale të kufizuara, për të punësuarit e përfshirë në veprimtari që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ekspozime profesionale? PMR			
6.	A sigurohet mbrojtja e të punësuarve në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, në përputhje me kërkesat themelore të standardeve të mbrojtjes nga rrezatimi jonizues?			

	PMR			
7.	A kanë vendosur punëdhënësit në vendin e punës vendimet apo udhëzimet që lidhen me masat për mbrojtjen dhe sigurinë profesionale duke dokumentuar nëpërmjet një procesverbali që mbahet ndërmjet palëve? PMR			
8.	A janë ndërmarrë masat për sigurimin e instalimeve të përshtatshme, sigurimin e pajisjeve dhe shërbimeve për mbrojtjen duke iu drejtuar edhe personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes apo institucionit? PMR			
9.	A janë ndërmarrë masat për sigurimin e shërbimit mjekësor në punë dhe të kontrollit shëndetësor? PMR			
10.	A janë ndërmarrë masat që sigurojnë pajisjet e nevojshme mbrojtëse dhe pajisjet monitoruese, si dhe instruksionin për përdorimin e tyre? PMR			
11.	A janë siguruar burime njerëzore të përshtatshme dhe trajnime të duhura për mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit në punë për të arritur nivelin e duhur të njohurive dhe të mbajnë dokumentacionin përkatës sikurse kërkohet nga standardet? PMR			

12.	A u sigurojnë punëdhënësit të punësuarve të ekspozuar ndaj burimeve të ndryshme për ato aktivitete që nuk janë të lidhura me punën e tyre ose nuk kërkohen nga puna e tyre, të kenë të njëjtin nivel mbrojtjeje si pjesa e popullatës së zakonshme? PMR			
13.	Përpara punësimit të punësuarve, a u kërkohet historiku i mëparshëm i ekspozimit të tyre dhe informacione të tjera të nevojshme për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë në përputhje me standardet e mbrojtjes nga rrezatimi jonizues? PMR <i>Nëse të punësuarit janë punësuar në punë që përfshijnë një burim që nuk është nën kontrollin e punëdhënësit, atëherë duhet të merret në konsideratë dhe ekspozimi shtesë.</i>			
14.	A janë ndërmarrë veprime administrative të nevojshme që sigurojnë se të punësuarit janë informuar, që mbrojtja dhe siguria janë pjesë integrale e programit të përgjithshëm të sigurisë dhe shëndetit profesional? PMR			
15.	E punësuarat kur e kupton që është shtatzënë a e njofton punëdhënësin me qëllim që kushtet e saj të punës të mund të ndryshohen kur është e nevojshme? PMR <i>Njoftimi i shtatzënisë nuk duhet të shihet si një arsye për pushimin e të punësuarës nga puna.</i>			
16.	Personat në moshën 14-16 vjeç a merren në punë që përfshijnë ekspozime profesionale, dhe personat nga mosha 16 deri 18 a			

	lejohen të punojnë në një zonë të kontrolluar dhe angazhohen vetëm për qëllime trajnimi? PMR			
--	--	--	--	--